

NEXHAT AGOLLI

**KARAKTERISTIKA TË PËRGJITHSHME TË VALLEVE TË GRAVE
E TË BURRAVE TË ZONËS SË RRAJCËS DHE BËRZESHTËS
(Rr. Librazhd)***

Lugina e sipërme e rrjedhës së lumit Shkumbin (zona e Rrajcës dhe e Bërzeshitës) është një nga zonat më të pasura e më të rëndësishme në fushën e valleve popullore. Për banorët e kësaj zone vallja, krahas gjinive të tjera të krijimtarisë folklorike, përbën një traditë të madhe. Ajo ka luajtur një rol të rëndësishëm duke u bërë shprehëse e mendimit popullor, e zakoneve, e gëzimeve, e hidhërimeve etj., të cilat janë lidhur me jetën, që nga kohët më të hershme e gjer në ditët tona.

Vallja dhe rituali — Duke i hedhur një vështrim llojeve të valleve, që luhen në këtë zonë dhe që praktikohen në raste të ndryshme, do të vëmë re se në disa prej tyre ruhen ende elemente ritualistike, qoftë në përmbajtje dhe trajtë. (Foto 1). Në raste të tjera ato luhen në mënyrë të zakonshme si shoqëruese të ritualit dhe më fort si valle me një për-



Foto 1

*) Ky punim është variant i shkurtër i studimit tonë *Valle nga rrethi i Librazhdit*, 1971.

mbajtje shoqërore më të gjerë, duke u lidhur me momente të rëndësishme të jetës.

Qëllimi ynë, këtu, nuk është të japim një kuadër të gjerë të ritualit dhe të elementeve ritualistike që ekzistojnë në vallen popullore folklorike; ne do të përqipemi të tregojmë disa nga momentet më të rëndësishme të ritualit me të cilat janë lidhur zakone, lodra dhe, ato që na interesojnë më tepër, vallet.

Nga të dhënat që kemi, konstatojmë se shumë nga këto zakone, këngë e valle, janë të lidhura me një sërë praktikash, që kanë të bëjnë me festa të ndryshme shoqërore si p.sh. me festat e pranverës, Shëngjergjin etj.

Këto festa rituale me karakter shoqëror, të lidhura me zakone të ndryshme, kishin të bënin me ringjalljen e natyrës, shtimin e prodhimit, luftën kundër së keqes etj...

Nga këto rituale kanë qenë edhe *Eremitë*. Festohej më tepër nga fëmijët. Për këtë rast ndizeshin zjarre para shtëpisë ose në vende të caktuara. Fëmijët silleshin rreth zjarrit, ose e kapërcenin atë, duke ligjëruar një sërë formulash me karakter magjik, «për të luftuar të keqen»: «Eremi, plastë gjarpri në shtëpi», »plastë miu«, ose luteshin për të rënë shi etj.¹

Një zakon tjetër ka qenë edhe ky: djem e vajza silleshin tri herë rreth shtëpisë duke i rënë këmborëve, zileve ose spërkitnin me ujë (nga një enë në të cilën kishin futur unaza floriri) bagëtitë kur dilnin nga vatha etj.

Një aspekt tjetër me rëndësi kanë qenë gostitë: *Kërshmet* dhe *Mënavigjet* etj. Të parat bëheshin në familje ose fshatçe mbasi mbaronin të lashtat, sidomos vjelja e misrit, kurse të dytat me rastin e lindjes së fëmijës së parë, veçanërisht për djalin. Në këto gosti, të cilat shoqëroheshin me darka, kënga e vallja luanin rol të dorës së parë.

Momente të tjera, në të cilat kënga e vallja janë përdorur dhe kanë krijuar emocione të larta, kanë qenë vajtjet për kurbet ose ushtar, sidomos kthimi.

Ceremoniali i dasmës përbën një tjetër moment të rëndësishëm në jetën e këtyre banorëve. Fejesa dhe dasma janë të lidhura me një sërë zakonesh, që janë kristalizuar si rezultat i një praktike të gjatë shekullore. Këto momente, në të kaluarën, ishin arena kryesore ku lindnin dhe praktikoheshin këngët, vallet, sidomos ato të grave.

Këngët, vallet e grave dhe të burrave, të shoqëruara me muzikë vokale ose instrumentale (cingonë e lodër), janë luajtur në momente të ndryshme të dasmës, p.sh. ditën e prerjes së druve, kur i përcillnin burrat për të bluar drithin, kur zinin qiçërat (brumin), tri net me radhë përpara dasmës; kur krushqit nisen për të marrë nusen, kur kthehen me nusen (në këtë kohë gratë i presin n'oborr duke kënduar, të zëna pas dore, me ecje të ndryshme (si «Mirse vjen sylarmë», «Ra ylli ndriti

1) Rreth tetëdhjetë vjet më parë, tregon N. Leka (dt. 1904, Bërzeshtë, sipas kujtimeve që ruan nga pleqtë), më 5 gusht në një vend pranë Bërzeshtës, që quhet Bungas (këtu ka qenë një kishë, murishtat e së cilës ruhen edhe sot), fëmijët mbledheshin e ndiznin zjarre. Për këtë rast pregatisnin ushqime. Fëmijët këndonin dhe luteshin për të rënë shi, ndërsa vinin rreth zjarrit të kapur për dore. AIF (Arkivi i Institutit të Folklorit). Të gjitha shënimet, citimet dhe titujt e këngëve janë marrë nga materialet e mbledhura nga ana jonë në ekspeditat koreografike të viteve 1965-67-69, në fshatin Rrajcë, Bërzeshtë, Prënjas e gjetiu.

mexhid», «Zbrit nuse prej kalit» etj.) dhe sidomos, po atë natë, pas gostisë. Mund të përmendim edhe raste të tjera si çastin kur e futnin nusen tek dhëndërrin (këndojnë këngë të tilla si «Nuse mos bëj gjumën-o», «Nuse më çel derën-o» etj.), të nesërmen mbasi ajo dilte nga dhoma e çonin për ujë në krua etj. Në dasëm, gratë dhe burrat rrinin të ndarë në dhoma të veçanta.

Përveç festave e zakoneve me karakter të gjerë shoqëror, mbeturina që mbartin elementë ritualistikë, ne mund të gjejmë edhe në vetë lëvizjet e ndryshme... në karakterin arkaik të melodive e të këngëve të valles, në trajtën e rrethit të mbyllur² me objektin në qëndër, si p.sh. në vallen «Mirse vjen sylarmë», e cila, përveç se n'oborr, luhet dhe në dhomë në vallen e dhëndërrit «Berberi që ruan mbrenë» si dhe në raste të tjera.

Një nga kërcimet e rralla me karakter kulti, ku shprehen elemente ritualo-magjike, është *Vallja e vdekjes* (Rrajcë) ose, siç e quajnë ndryshe *Vallja me thuma* (Bërzeshtë). Sado që gojëdhana popullore e lidh ndonjëherë origjinën e saj me periudhën e Skënderbeut,³ nëpërmjet përmbajtjes plastike dhe formës së valles gjejmë të sintetizuar artistikisht botëkuptimin popullor të triumfit të jetës mbi vdekjen.

Këto shfaqje, apo elemente ritualistike, nuk janë gjë tjetër veçse mbeturina të trashëguara, që e kanë humbur funksionin e tyre fillestar. Veçanërisht sot, me vendosjen e marrëdhënjeve të reja socialiste në prodhim, kur njeriu ka fituar njohuri, ndërgjegje të lartë e besim në veten e tij nëpërmjet punës së përbashkët, këto elemente kanë dalë, pothuaj, jashtë përdorimit. Edhe kur disa prej tyre përdoren, siç janë trajta e *rrethit të mbyllur*, apo vallet në ceremonialin e dasmës (shumë zakone nga të cilat edhe janë lënë), *Vallja e vdekjes* etj., valltaret, në esencë, nuk kërkojnë të shprehin idenë fillestare, porse i praktikojnë si një trashëgim brez pas brezi, duke i konsideruar ato argëtime, ose lojë (p.sh. *Vallen e vdekjes*). Në një variant të kësaj valleje, valltari i parë shtrihet sikur të ketë vdekur; në këtë çast i afrohet surlexhiu dhe i fryn afër veshit melodinë e re, të kthesës. Valltari çohet menjëherë i trëmbur dhe pas këtij çasti fillon kthesa e gëzueshme e valles. Gjithë këto janë elemente pantomimike që ka fituar vallja. Kjo tregon se *Vallja e vdekjes* e ka humbur domethënjen rituale dhe është shndërruar në një valle lojë. Këto elemente vërtet po bjerrin, por në të njëjtën kohë, të kushtëzuara nga jeta dhe ideali në kuadrin e marrëdhënjeve kooperative, po fitojnë tipare të reja. Por, duhet patur parasysh karakteri

2) Formën e rrethit të mbyllur e gjejmë në Shushicë (Elbasan), Obot (Shkodër), Rradokal (Pogradec) dhe Moisit (Tiranë). Për këtë shih N. Agolli — R. Bogdani, *Vallja si shprehje e ndjenjave dhe e mendimeve të gruas në jetën shoqërore*, «Studime filologjike», 1968, Nr. 4; S. Selimi, *Mbi lashtësinë e valles shqiptare*, kumtesë e mbajtur në Konf. e Studimeve Albanologjike 1968 (Mat. i pabotuar, AIF).

3) N. Leka, sipas kujtimeve që ruan nga pleqtë, e lidh origjinën e kësaj valleje me ngjarjet rreth shkatërrimit të Sopotit dhe vrasjen në masë të banorëve. e cila duhet të ketë lënë gjurmë të thella në kujtesën e njerëzve. Pra, kjo valle; sipas tyre, bën aluzion për dëshpërimin e madh që shkaktoi ajo ngjarje, aq sa u përgjithësua me disa lëvizje me karakter «kulti». Mundet — sipas mendimit tonë — kjo valle të jetë një ritual i hershëm, por që vendasit ta kenë lidhur, më vonë, me ngjarjen e shkatërrimit të Sopotit dhe dëshpërimin e madh që shkaktoi në popull.

konservator, që ka në përgjithësi arti i valles popullore folklorike, pra ndaj këto ndryshime ndodhin në mënyrë jo të menjëhershme. Ky problem do të trajtohet në fund të këtij studimi.

Vallet dhe shoqërimi muzikor — Para se të merremi me paraqitjen dhe analizën e materialit koreografik të kësaj zone (që përfshin elemente, lloje kërcimi nga treva veriore e jugore), le të shohim shkurtimisht si paraqitet vallja popullore folklorike, përkatësisht në të dyja këto ndarje: veriun dhe jugun, duke mos e shkëputur nga fenomeni muzikor si element shoqëruës. Kështu, për analogji, krahas mendimeve që do të shfaqim lidhur me llojet e kërcimit, strukturën, tiparet e karakteristikat e tyre, do të arrijmë përafërsisht në përcaktimin e fizionomisë koreografike të kësaj zone.

Në krahun e djathtë të Shkumbinit e lart luhen valle të kënduara dhe valle të shoqëruara me surle e lodër. Të parat luhen nga gratë, por edhe nga burrat (për disa krahina), kurse të dytat vetëm nga burrat⁴. Kjo përbën mënyrën tradicionale. Nuk përjashtohen edhe rastet e shoqërimit të valleve të grave me çifteli, kohët e vona edhe me surle e lodër në disa raste. Përkundrazi, në krahun e majtë të Shkumbinit e poshtë, në jugë, luhen valle të kënduara si nga gratë dhe burrat. Nuk përjashtohet rasti i shoqërimit të valleve edhe me saze për shumë zona, veçori kjo e cila paraqet tendencë (herë sazet bashkëjetojnë me këngën, herë zënë vendin e tyre). Ndërsa në trevën e veriut, është karakteristike, për shoqërimin e valles, muzika homofonike, për jugun është muzika polifonike. Megjithatë, në këtë të fundit, ka edhe zona ku këndohet e kërcëhet me muzikë homofonike.⁵

Tani le të kthehemi në zonën e rrjedhjes së sipërme të luginës së Shkumbinit. Këtu fenomenin e shoqërimit vokal e instrumental të valles e ndeshim, si në njërin ashtu dhe tjetrin krah të lumit, për të dy sekset.

Meloditë që i shoqërojnë vallet e grave paraqiten dy llojesh: polifonike (shumë zërash) dhe homofonike (me një zë). Këngët polifonike janë karakteristike për fshatrat e krahut të majtë të Shkumbinit, homofoniket për krahun tjetër. Ato me elemente diafonike dhe heterofonike i ndeshim, në të dy pikat e mësipërme por më fort në Urakë, Kotodesh etj. Kohët e vona vallet e grave kanë filluar të shoqërohen edhe me cingonë e lodër tërësisht ose pjesërisht (d.m.th. edhe me këngë edhe me instrumenta).

Ky gërshetim shpjegohet me faktin se zona në fjalë është nyje kalimtare ndërmjet trevës jugore e asaj veriore, pra edhe ndërmjet mënyrës polifonike e asaj homofonike të të kënduarit. Sot, vihet re, sidomos në Bërzesh të, një farë tendence drejt homofonizimit, sidomos të këngës me përmbajtje të re kënduar nga të rejtat⁶.

4) Kjo ndarje e natyrshme — shkruan R. Sokoli — nuk është nga ato ligjet absolute që s'kanë përjashtim ...Më poshtë shkruan se... jonet vokale të gegërisë janë vetëm homofonike dhe antifonike. Nga ana tjetër, poshtë Shkumbinit këngët qytetare të Beratit bashkë me ato të Lushnjës dhe të Fierit janë homofonike, gjithashtu këngët grarishte të Çamërisë. Sigurisht, këto mund të kundrohen si përpjesëtime që e përforcojnë rregullin e përgjithshëm. *Folklori muzikor shqiptar*, Bot. Instituti i folklorit 1965, f. 127.

5) Bën përjashtim *Vallja e Tropojës*, që luhet me lodër si nga gratë ashtu dhe nga burrat.

6) AIF (Fonoteka) Këngë të inçizuara në ekspeditën e rrethit të Librazhdit 1965, 1967, 1969.

Vallet e burrave paraqiten dy llojesh: valle të kënduara, të shoqëruara me këngë polifonike dhe valle të shoqëruara me cingonë e lodër. Të parat i përkasin kryesisht trevës jugore, kurse të dytat kryesisht trevës veriore, po në zonën e studimit në fjalë, këto dy lloje kërcimi e kapërcejnë kufirin tradicional, lumin Shkumbin.

Vallja e kënduar polifonike e burrave e kapërçen shtratin e këtij lumi duke u shtrirë edhe në fshatrat Rrajcë (Sutaj, Skënderbej ose katundi Plak), Rreshtan, Pishkash, Qukës-Shkumbi, Skroskë, Velçan, Vulçan, Kokrevë, Hotolisht e Dragostunjë. Nga të dhënat që kemi, ky i fundit, njihet si kufiri i fundit i kësaj lloj kënge, për rrjedhim, edhe i valles së kënduar polifonike të burrave. Shtrirja gjeografike e këtij fenomeni, për analogji, përputhet me atë gjuhësore të rotacizmit.*

Vallja e shoqëruar me cingonë e lodër gjithashtu e kalon shtratin e këtij lumi, duke kaluar në të majtë të tij në një zonë relativisht më të madhe (se ajo e valles së kënduar polifonike të burrave në krah të djathtë) dhe kryesisht në këto fshatra: Bërzeshtë, Fërret, Fanjë, Karkavec, Sopot, Qukës-Skënderbe, Xhyrë, Dardhë, Spatharë, Babje e Polis. Pra, shkon deri në kufi me Gramshin e më tutje me rrethin e Elbasanit.

Në qoftë se vallja e kënduar polifonike e burrave shfaqet në krahun e djathtë të lumit, në tërësinë e saj të mirëfilltë, vallja e shoqëruar me cingonë e lodër, shfaqet si tip, në të majtë të tij. Herë-herë motivet e kësaj të fundit gërshetohen edhe me motivet koreografike të valles së kënduar polifonike; jo rrallë kombinime lëvizjesh paraqesin ngjashmëri, në të dy këto lloje vallëzimi, sidomos në kthesat e valleve.

Nga sa u tha, rezulton se në shumë drejtime, nga juglindje (me rrethin e Pogradecit), nga jugu (me rrethin e Gramshit), nga jugperëndimi (me rrethin e Elbasanit) dhe, në të kundërt, nga veriu e veriperëndimi i rrethit të Librazhdit, vijën e lokalizohen në luginën e sipërme të rrjedhës së Shkumbinit elementet polifonike, diafonike, heterofonike e homofonike të këngës që e shoqërojnë vallen e kënduar nga njëra anë, dhe ato të valles së shoqëruar me cingonë e lodër nga ana tjetër.

*Vallet e grave*⁷

Kur flasim për vallet e grave kemi parasysht, parasëgjithash, ceremonialin e dasmës si një nga momentet më të rëndësishme në jetën e tyre. Dhe, jo vetëm vallja, por edhe fjala, kënga, veshja (zakonet e ndryshme) me të cilat ajo është lidhur etj., kanë qenë të pandara

* Një mendim të tillë ka shprehur kohë përpara Q. Haxhihasani në studimin e tij *Një vështrim mbi të folmen e krahinës së Sulovës*, ku ndër të tjera shkruan: «Kufijtë e fenomeneve të tilla gjuhësore pajtohen edhe me fenomene folklorike dhe etnografike. Në katundin Dragostunjë jeton elementi i fundit dialektik jugor: rotacizmi (në katundet ngjitur me të nga p. dhe v. ky fenomen nuk vihet re ma); pikërisht në këtë katund merr fund edhe mënyra e të kënduarit të këngëve popullore me iso ose ajo e kërcimit të valleve me dy vetë, si nga Shqipëria e jugut». (Sigurisht autori ka parasysht vallet e kënduara polifonike; termi kërcim me dy vetë nuk e shpreh esencën tipike për vallen e jugut, se edhe në veri luhen valle me dy vetë. Madje në jugë ka edhe valle që luhen edhe me shumë valltarë të shoqëruara me këngë ose me saze. — Shënim i N.A.). Buletin i shk. shoq, 1955, f. 148

7) Ndoshta jo me të drejtë këto kërcime i janë atribuar vetëm grave. Në përgjithësi në vendin tonë repertori i valleve të grave është luajtur edhe nga të rejat. Në dasëm fjalën e kishin të moshuarat, gratë, pastaj vinin vajzat. Sidoqoftë ky zakon po ndryshon. Emërtimi *valle grash* është përdorur edhe me kuptimin si gjini, për t'i dalluar nga vallet e burrave.

nga ky ritual. Këto forma artistike, në një shkallë të madhe, janë lidhur me jetën e gruas pra, duke patur funksion shprehës ato, në kuadrin e valles, kanë pasqyruar botëkuptimin, nivelin dhe pozitën e saj në jetën shoqërore të kësaj zone.

«Gruaja shqiptare në të kaluarën ishte e varur dhe e shfrytëzuar ekonomikisht dhe shoqërisht»⁸. Ajo ishte e privuar dhe nuk gëzonte asnjë të drejtë në familje dhe në shoqëri. Në kushtet e familjes patriarkale ajo u bë skllave e vërtetë, konsiderohej si krah pune dhe mjet për të lindur fëmijë. Në këto rrethana ajo u izolua, bile edhe në gëzimet familiare, sidomos në dasëm, gratë rrinin të veçuara nga burrat, në dhoma të veçanta. Ky veçim me kohë çoi në zhvillime të ndryshme të këngës dhe të valles, si në përmbajtje ashtu dhe në formë. Në repertorin e grave «... si këngët po ashtu edhe vallet, kishin një përmbajtje lirike, jo aq për kushtet e tyre fiziologjike, po, në radhë të parë, për kushtet e tyre shoqërore, konservatore»⁹. Në këtë kuadër duhet ta shohim edhe jetën e gruas së kësaj zone, këngët e vallet që ajo krijoi e trashëgoi brez pas brezi.

Vallet e grave të kësaj zone janë shoqëruar me këngë. Kjo përbën formën tradicionale. Këngët¹⁰ kanë si figurë qendrore, vajzën, nusen. Ato përrshkohen nga një frymëzim i thellë, i singertë, i shprehur me vërtetësi e origjinalitet. Shumë prej tyre bëjnë fjalë për ndjenjën e pastër të dashurisë ose japin portretin fizik të nuses: *Hidhmi leshkat prapa, / moj vetull kurorë, / Çfaj të pati djali / që s'i flet me gojë ose: Ta hoqa dubakun, të pashë stolinë/ Më dogje në zemër, erë trendelinë.* Disa të tjera lidhen me momente të caktuara nga ceremoniali i dasmës, p.sh. kur vjen nusja: *Zbrit, nuse, prej kalit, / Xhan nuse të keqen;* ose këngët: «*Na zbriti me yll në ballë*», «*Mirë se vjen sylarmë*», *Paska shtatin si selvi*, «*Trëndafil i bardhë*» etj. Këngë të tjera i kujtojnë nuses punët e shtëpisë. S'kanë munguar dhe këngë, ku gruaja të shprehë gjendjen e saj të vetmuar, të trishtuar.

Repertori i këngëve që shoqërojnë vallet e grave është pasuruar vazhdimisht, veçanërisht me këngë të periudhës së Luftës nacionalçlirimtare e të ndërtimit socialist në fshatin e kolektivizuar. Në këto këngë i këndohet jetës së re që ka lindur me fjalët më të ngrohta; i këndohet Partisë, shokut Enver, që sollën këto ditë të gëzueshme e që *si diell dhe jetë janë për vendin tonë*.

Në vështrimin koreografik vallet tradicionale të grave paraqiten të thjeshta me një plastikë jo aq të zhvilluar. Një fenomen i tillë duhet të jetë kushtëzuar nga rrethanat, marrëdhënjet shoqërore dhe roli që luante në jetën e përditshme gruaja e kësaj zone. Ceremoniali i dasmës përbënte të vetmin rast ku ajo pasqyronte botën e saj shpirtërore, jashtë çdo kontakti të vazhdueshëm me jetën që e rrethonte. Sundimi i huaj, feja, vendi i vogël brenda dhomave ku zhvilloheshin dasmat, gjithashtu kanë ndikuar në këtë drejtim.

Por, në repertorin e këtij lloj vallëzimi, vëmë re se edhe kërcime me një fizionomi më të plotë, qoftë sa i përket anës plastike, nuancave apo si motive. Në këtë rast kemi të bëjmë me zhvillimin që ka pësuar vallja. Ato luhen qetë, ngadalë, por nuk mungojnë edhe lëvizjet e gjalla, ekspresive. Herë-herë hapat normale paraprihen nga hapa më të vogla ose më

8) E. Hoxha, *Mbi problemin e gruas*; f. 68; 69.

9) Z. Sako, *Gruaja në shoqërinë shqiptare dje dhe sot*, Tiranë 1969, f. 19.

10) Këngët e valleve janë të njohura pothuaj në të gjithë këtë zonë.

të mëdha në gjysëm ulje, me kthimin e trupit majtas, djathtas ose nga e kundërta, duke krijuar kështu nuanca të lehta por të dukshme. Vështrimin e syve e hedhin nëpër tokë ose e drejtojnë nga njëra-tjetra. Në këtë mënyrë përmbajtja, disi, sikundër dhe motivet përkatëse ndryshojnë, simbas rastit, nga njëra valle në tjetrën. Karakteri i këtyre valleve është i lidhur ngushtë me përmbajtjen lirike të këngëve, të vijës melodike të thjeshtë e me ritëm të shtruar. Këto komponente, vargu, melodia dhe lëvizja shkrihen organikisht, duke i dhënë mënyrës së kërcimit një fizionomi të veçantë.

Këngët dhe vallet e grave, në të kaluarën, nuk dilnin jashtë mureve të shtëpisë, bile as jashtë dhomave ku zhvillohej ceremoniali i dasmës. Jeta e mbyllur dhe privacionet e mëdha të gruas, në kuadrin e familjes patriarkale e më vonë asaj feudale, u pasqyruan krejtësisht në këto valle, në repertorin, përmbajtjen dhe stilin e tyre. Këto kërcime, në tërësinë e tyre (në përmbajtje dhe strukturë), në një mënyrë ose tjetër, u bënë shprehëse të gjendjes, nivelit dhe pozitës së gruas në shoqëri. Në kushte të tilla shtypjeje, ku jetonte gruaja, nuk mund të mendohej, si për shumë anë të tjera edhe për zhvillimin e dukshëm të përmbajtjes e të formës së këtyre kërcimeve. Kjo u bë e mundur vetëm pas çlirimit të atdheut dhe fitores së revolucionit popullor, nën udhëheqjen e Partisë, që i dha gruas dhe vajzës së kësaj zone, jo vetëm lirinë por dhe mundësinë e ndihmën për çlirimin e tyre një herë e përgjithmonë nga zakonet e këqija të së kaluarës së errët.

Vallet e kënduara të grave shoqërohen me këngë të ndryshme. E njëjta valle mund të shoqërohet me një ose më shumë tekste. Pra, motivet e valleve përsëriten, ato janë më të pakta në krahasim me tekstet, bile edhe me meloditë që i shoqërojnë.

Këto dy dekadat e fundit për shoqërimin e valleve të grave kanë filluar të përdoren edhe cingone me lodrën. Nuk mund të themi kurrësesi që përdorimi i tyre po e lë mënjanë shoqërimin me këngë; përkundrazi, shoqërimi i valles me këngë vazhdon të praktikohet, qoftë më vete, qoftë i gërshetuar me cingonën e lodrën në këtë mënyrë: në fillim këndohet e kërcëhet vargu i parë (i përsëritur dy herë) ose dy vargjet e para, simbas rastit dhe, fill pas kësaj, vazhdon vallja e shoqëruar me cingonë e lodër. Në këtë rast luhet e njëjta melodi, natyrisht me karakter dinamik më të theksuar. Tendencë po bëhet shoqërimi i këtyre valleve edhe vetëm me cingonë e lodër, sidomos në manifestimet me karakter shoqëror, festivalet folkloristike etj.

Nëse vallet e kënduara luhen shtruar, qetë e në mënyrë të hijshme, përkundrazi vallet që shoqërohen njëkohësisht me këngë, cingonë e lodër ose vetëm me këto dy instrumenta, paraqesin një përmbajtje plastike e ritmike më të zhvilluar. Instrumentat popullore kanë çuar, veç faktorëve të tjerë, në dinamizmin, gjallërimin e këtyre valleve, për rrjedhim edhe në rritjen cilësore të lëvizjes, të mënyrës së interpretimit etj. Këto ndryshime kanë të bëjnë me zhvillimin e përmbajtjes e të anës formale të valles së grave; një tipar i tillë sot është fort i dukshëm.

Në vështrimin struktural, motivet e valleve që shoqërohen me instrumenta popullore, paraqiten më të pasura në krahasim me ato të valleve të kënduara. Në ndikimin e përmbajtjes, ritmit të melodisë dhe të llojit të instrumentave, ato krijojnë variacione plastiko-ritmike, duke u dhënë kështu valleve respektive një fizionomi më të plotë dhe më të përcaktuar strukturale.

Vallet e grave luhen nga dy valltare, «dyshe» dhe nga katër a më

shumë «grup». Të parat shoqërohen me këngë polifonike, kurse të dytat me këngë homofonike. Nuk përjashtohet rasti që në dasëm, kur vendi është i vogël, të kërcëjnë dhe vetëm dy gra që këndojnë në mënyrë homofonike ose heterofonike. (Foto. 2) Në rastin e valles «dyshe», kur kjo shoqërohet me këngë polifonike, valltarja e parë ja merr, e dyta ja pret, kurse shoqet që mbajnë ison rrijnë në vend pa lëvizur. (Foto 3.)



Foto 2



Foto 3

Në vallet «grup» marrin pjesë të gjitha valltaret të cilat janë njëkohësisht edhe këngëtare. Siç shihet, numri dhe roli i valltareve në valle është i lidhur me funksionin që kanë ato në ekzekutimin e këngës. Këtu përfshihen edhe ato valle që shoqërohen njëkohësisht me këngë dhe instrumenta popullore ose vetëm me këta të fundit. Kalimi nga polifonia në homofoni (si p.sh. në disa këngë edhe të folklorit të ri, që këndohen në Bërzeshtë e gjetiu), çlirimi pjesërisht ose tërësisht i valltareve nga të kënduarit në valle, kur shoqërohen me instrumenta popullore (sidomos në Rrajcë, Prenjas-fshat, Bërzeshtë etj. nga të rejat) luajnë rol në ndryshimin e përmbajtjes plastiko-ritmike dhe në përgjithësi, të karakterit e të stilit të këtyre valleve. Gjithashtu vihet re (p.sh. në fshatin Bërzeshtë) se këngët homofonike, qoftë edhe ato të folklorit të ri, luhen nga shumë valltare. Pra, krahas formës «dyshe», bashkëjeton edhe forma në «grup» (Foto 4).



Foto 4

Në të dyja këto forma kërcimi valltarja e parë e lëviz shaminë me dorën gjysëm të ngritur ose të ngritur lart, kurse e dyta ose e fundit dorën e majtë e mban anash, në bel, herë me gjithë shuplakën e dorës, herë grusht. Lëvizjet e valles bëhen vazhdimisht në drejtim të vargut të valles, anash nga e djathta (në ndonjë rast edhe nga e majta), në një rreth relativisht jo të madh.

Vallet e kënduara të burrave — Vallja e kënduar polifonike, si tip, përbën formën më të vjetër të vallëzimit, që është praktikuar nga burrat prej kohëve më të hershme e gjer sot. Është vështirë të flasësh për vjetërsinë e kësaj valleje. Natyrisht, një ide do të na jepte, në këtë rast, lloji i muzikës që e shoqëron, përderisa bashkëjetesa e këtyre komponentëve ka çuar në kristalizimin e këtij tipi kërcimi. «Vetë emërtimi i polifonisë popullore, ashtu si dhe tiparet e saj origjinale (nënvizimi është imi) na dëshmojnë se ajo është trashëgim i një kulture të lashtë që ka lindur këtu në vend.»¹¹

Vallja e kënduar polifonike, që luhet në të dy anët e rrjedhës së sipërme të luginës së Shkumbinit, i përket formës «dyshe të thatë» dhe

11) R. Sokoli, *Vep. e cit.*, f. 136.

«përqarke»¹². Ajo përfaqëson një fenomenideo-artistik të lindur e të zhvilluar në kushte historike të caktuara.¹³ Më poshtë do të mundohemi të japim disa tipare karakteristike dhe vlerësime të përgjithshme të kësaj valleje.

Vallja e kënduar polifonike e burrave konsiderohet nga vendasit si një nga manifestimet artistiko-shoqërore më të vjetra, më të dashura, nëpërmjet së cilës ata, gjatë shekujve, kanë shprehur mendimet, dëshirat dhe ndjenjat e tyre. Gjithë këtë botë të brendshme, me gëzimet e shqetësimet e tyre ata i kanë shprehur me emocione shumë të thella përmes tingujve, përmbajtjes muzikore të këngës, karakteristika të së cilës janë itonacionet lirike me elemente epike dhe lëvizjet plastike tepër shprehëse e kuptimplote të valles. Ajo, gjatë ekzistencës së saj është kristalizuar dhe, duke qenë e pandarë nga teksti, karakteri dhe forma e këngës polifonike, ka formuar fizionominë e saj si valle e tipit «dyshe». Është kjo arësyeja që vallja e kënduar nuk mund të merret më vete, e shkëputur; ajo është edhe «tregim» edhe «këngë» edhe «valle». Pikërisht janë këto komponente që shprehin nga pikëpamja plastike, gojore e muzikore një mendim të thellë në këtë kërcim.

Këto karakteristika që përmendëm lidhen edhe me funksionin e dyfishtë të interpretuesve, të cilët janë njëkohësisht këngëtarë e valltarë. Kjo nga një anë paraqet vështirësi, por u jep mundësi atyre të shprehin lirisht mendimin, emocionet që ndjejnë në momentin e caktuar kur luhet vallja. Ndoshta në këtë veçori duhet ta kërkojmë atë përmbajtje të thellë liriko-poetike, herë-herë edhe me shpërthime të një karakteri dinamik (veçanërisht tek kthesa e valles), që është tipike për vallen «dyshe» të kënduar.

Tek kjo valle spontaniteti spikat më fort se në çdo lloj vallëzimi tjetër. Jo më kot vendasit thonë: «Që të luajsh këtë valle duhet të jesh këngëtar dhe valltar i zoti; po nuk dije të këndosh, t'ja marrësh këngës, nuk din të kërcesh, se fjala është e lidhur me ogrin (melodinë) dhe sipas kësaj të fundit shkojnë (hidhen) hapat, thyhet trupi, i cili bën ojme, gjithfarë xhestesh, herë qetsohet, herë ngrihet, herë rrëshqet, herë ulet». Shpeshherë valltari i parë ndalet kur do të tregojë diçka me fjalë, i mëshon zërit, u jep zemër shokëve, por përnjëherë fillon të kërcëjë duke shprehur (herë qetë, herë hovshëm) kënaqësinë që ndjen n'atë çast ose ndjenja të tjera. Të gjitha këto i japin valles së kënduar ngjyrat e një poezie të vërtetë, ndërsa nga vështrimi plastik do ta krahasonim me një valë gjarpëruese që rrëshqet, por që herë pas herë këputet.

Tekstet e këngëve që i shoqërojnë këto valle janë të karakterit lirik¹⁴; por jo çdo këngë shërben për shoqërimin e valles. Vendasit për

12) Megjithëse nuk është bërë një studim i veçantë, prapëseprapë, nga të dhënat e materialet e mbledhura në terren vëmë re ekzistencën e valles së kënduar të trevës jugore që paraqitet në disa tipe: *Devollitçja*, *Dyshja*, *Përqarkja*, *Vallja labe*.

13) Vallja «dyshe» si një nga tipet e valles së kënduar luhet në një zonë më të madhe që përfshin nga veriu Shkumbinin, nga jugu Vjosën, nga perëndimi detin Adriatik, kurse nga lindja shkon deri përtej kufijve shtetërorë. Siç thamë edhe më lart, shumë faktorë, marrëdhënjet ekonomiko-shoqërore, terreni, lëvizjet e popullatës, tranzumancat, lidhjet ekonomike me tregun, martesat etj., kanë çuar në kristalizimin e këtij tipi vallëzimi. Për këtë problem shih N. Agolli, *Valle popullore*, Böt. i Institutit të folklorit, 1965.

14) Përsëritja e këtyre valleve, zakonisht në dasma, varet edhe nga renditja (përmbajtja) e vetë këngëve.

këngën polifonike, që vetëm këndohet, përdorin termin «këngë ulur», kurse për atë që përdoret për shoqërimin e valles, termin «valle më këmbë». Madje, këto dy tipe këngësh dallohen edhe për mënyrën e interpretimit. Të parat merren shtruar, kurse të dytat karakterizohen nga një ritëm e thekse më të përcaktuara. Ja disa nga këto këngë: «Berberi që ruan mbrenë», «Atje poshtë te çezm' e bardhë», «Ç'u mbush mali plot me dushk», «Ky dysheku rrumbullak», «O moj oda me tavan», «Dhëndërro zinxhir argjend», «O moj e vogëla në lëmë», «Djali vogël axhami» etj.¹⁵

Vallja e kënduar e kësaj zone nuk luhet vetëm me këngë, ajo shoqërohet edhe me muzikë instrumentale (me cingonë e lodër).¹⁶ Kjo praktikë ka çuar në krijimin e dy varianteve për vallen e kënduar, që shprehen, përkatësisht, edhe me emërtime të veçanta: *Valle e thatë* dhe *Valle përçarke*. Në rastin e parë vallja luhet, siç thonë vendasit, vetëm me këngë, kurse në rastin e dytë, përveç se me këngë, shoqërohet edhe me cingonë e lodër. Në të dyja këto forma kërcimi ruhet trajta «dyshe». *Vallja e thatë* luhet vetëm me dy valltarë. Përkundrazi, tek *Përçarcka*, sikundër shoqërimi vokal gërshetohet me atë instrumental edhe forma dyshe çfaqet herë pas herë duke u alternuar me formën e kërcimit në gjysmë rrethi nga të gjithë valltarët; pra, kemi një shfaqje paralele të formës tradicionale «dyshe» me atë të evolucionar (të paktën në këtë zonë) në «gjysmë rrethi». Këngët që shoqërojnë *Vallen e thatë* dhe *Përçarcken* janë të caktuara pothuaj.¹⁷ Këngët e valleve luhet edhe simbas rastit në një mënyrë ose në një tjetër. Dikush e merr vallen të «thatë» (sidomos pleqtë), dikush tjetër e merr «përçarcke» edhe me cingonë e lodër. Kjo shpesh varet nga qenja ose mungesa e instrumentistëve. Zakonisht *Vallja e thatë* luhet në dhomë, oborr, kurse *Parçarcka* në lëmë, në shesh të hapët. Zakoni — thonë pleqtë — e donte deri në tri cingona dhe dy lodra. Cingona e parë ja merr, e dyta ja mban, e treta bën iso, kurse lodrat i japin valles ritmin.¹⁸

Futja e elementit muzikor ka sjellë me vete ndryshime edhe në tërësinë e këtyre dy varianteve. Le të njihemi shkurtimisht me strukturën dhe karakteristikat e tyre.

Në *Vallen dyshe të thatë* merr pjesë i gjithë grupi, por funksioni i tyre ndryshon. Në këtë rast kërcëjnë vetëm dy të parët, ndërsa të tjerët qëndrojnë në vend duke mbajtur ison. Ashtu si në këngë, ku i pari ja merr këngës edhe në valle po ai person e hedh vallen. Ky paraqet tekstin koreografik, nga ky varet interpretimi, tek ky nuancat e trupit e lëvizjet

15) Motivet e këtyre këngëve këndohen pothuaj në gjithë zonën e Toskërisë, që shtrihet ndërmjet Lumit Shkumbin dhe Vjosë.

16) Ka mundësi që forma e shoqërimit të valles së kënduar me cingonë e lodër të jetë karakteristike e mirëfilltë vetëm për këtë zonë. Informatori K. Cani (dt. 1915) nga Polisi thotë se: «Vallet e thata më të bukura i kanë Vërça, Sulova, Shpati, Dumreja, etj. Mua, bashkë me shokët e mij, na thërrisnin në këto vende për aheng, si ustallarë që ishim, me cingone e lodër. Ata kërcenin vallet e tyre me këngë Kërkonin që ne t'u binim veglave. Ne detyroheshim t'i mësonim meloditë dhe, ndërsa i binim veglave, ata kërcenin. Në këtë mënyrë gërshetohej kënga me cingonën e lodrën. Por, sazet për fusharakët kanë qenë më të përdorshme, sepse i merrnin shtruar vallet. Këtu, ndoshta, sipas mendimit tonë, mund ta gjejmë shkakun që, me përhapjen e sazeve, veçanërisht nga Shqipëria e mesme, në zonën fushore të Myzeqesë, lodra dhe cingona nisën të dalin jashtë përdorimit.»

17) Si *Përçarcke* njihen: «Berberi që ruan mbrenë», «Sot manushaqja me shëndet», «Djali vogël axhami», «Sala i vogël». etj.

18) Në këtë rast kemi përfitim zërash mbi bazën e këngës polifonike. Nuk janë të rralla rastet kur edhe në trevën e veriut vallet shoqërohen me dy surle.

e duarve janë më të dukshme, prej tij varet kalimi nga njëra lëvizje, apo nga njëra pjesë e valles tek tjetra.¹⁹ I dyti, i cili ja mban këngës, në valle, luan rol të dytë, plotësues. Të tjerët që mbajnë ison qëndrojnë në vend.

Në këtë vështrim duhen kuptuar pjesëmarrja, roli dhe mundësitë shprehëse të valltarëve nga njëra anë, ashtu dhe aftësitë vetiake nga ana tjetër, që në këtë tip valleje, sikundër edhe në këngë, shfaqen në mënyrë të dukshme. Por, duhet të theksojmë se, me gjithë spontanitetin në ekzekutim, për çdo valltar mbetet i përbashkët ai trung lëvizjesh dhe ai karakter mbi të cilin mbështeten për ta luajtur dhe interpretuar këtë tip valleje. Tek valltarët e mirë asgjë e improvizuar ose e krijuar në interpretim, qoftë edhe në vetë lëvizjet, nuk qëndron e zbehtë, e shkëputur; ajo është në çdo rast në funksion një moment shprehjeje lidhjeje dhe pasurimi i valles në veçanti, ashtu dhe i stilit të këtij lloji vallëzimi në përgjithësi.

Vallja dyshe e thatë nuk fillon menjëherë. Në fillim nis kënga (ku temën kryesore e paraqet këngëtari i parë) dhe fill pas kësaj, në një çast të përshtatshëm, ata e fillojnë kërcimin më shpesh kur kënga precizohet nga ana ritmike. Vallja nis shtruar, ngadalë, me lëvizje të lehta, në përgjithësi me hapa normale të thyera përpara, prapa, me lëvizje të shumta të pjesës së sipërme të trupit etj. Kjo zgjat gjersa mbaron fraza muzikore, në të cilën ligjërohet vargu i parë. Rastis që i pari e ndal vallen pa mbaruar deri në fund fraza muzikore, ndërkaq e vazhdon këngën duke ecur me hapa të thjeshta në rreth. Ky moment, ecja, herë-herë koïncidon edhe me mbarimin e frazës, pikërisht me zgjatjen e zanores së fundit, që përbën, nga pikëpamja muzikore, pedalin, një farë burdoni zakonisht në tonikë ose siç thonë vendasit, ison. Si mbaron vargu i parë i këngës, fillon i dyti, i treti e kështu me radhë. Ndërkaq kërcimi sa vjen e bëhet më tërheqës. Pas këtij çasti vjen pjesa e dytë e valles. Kjo është kthesa e valles ose, siç thonë vendasit, «thyerja» e «prera» (këtu vallja këputet). Si rregull vallja thyhet në një varg të caktuar, zakonisht në dy vargjet e fundit.²⁰ Jo më kot, thonë ata vallja thyhet dy herë. Duart sidomos në pjesën e parë të valles lëvizin në mënyrë të pacaktuar, kjo varet më tepër nga dëshira e valltarit të parë. Në çastin kur vallja thyhet, dy valltarët kërcëjnë më të gjallë, duke u ulur, rrotulluar e hedhur; në këtë çast shkëputen, herë kapen me njërin krah (ose dorë), e herë me tjetrin. Gjatë kërcimit pjesën e sipërme të trupit e mbajnë të përkulur pak përpara, sidomos në uljet, rrotullimet. Një nuancë e tillë ruhet edhe kur valltarët këngëtarë e nisin frazën e re ende pa mbaruar lëvizjet; atëhere ecin me të shpejtë në rreth me hapa të vogla, derisa e gjejnë çastin për t'ja nisë përsëri kërcimit (është

19) Një karakteristikë e tillë vihet re edhe në melodinë shoqëruese të këtij tipi kërcimi, pikërisht në rolin e këngëtarit të parë e të dytë. «Melodinë kryesore e ka zëri i parë «marrësi», i cili është edhe udhëheqës i grupit. Në përgjithësi melodia e këtij është e pasur me ornamente, melizma, glisando etj. Njëkohësisht edhe zëri i dytë «mbajtësi» si dhe zëri i parë përshkohet nga një varg elementesh shprehëse. I gjithë teksti është paraqitur nga këngëtari i parë, ndërsa i dyti këndon vetëm fragmente. Shpesh këngëtari i dytë plotëson melodinë dhe tekstin e këngëtarit të parë në kohën kur ky i fundit e ndërpret këngën për arsye të ndryshme: për të marrë frymë ose kur e quan të panevojshme të vazhdojë melodinë, e cila medoemos këndohet dhe plotësohet nga këngëtari i dytë». B. Kruta, *Vështrim rreth këngës popullore polifonike të burrave të krahinës së Myzeqesë*, Stud. filologjike 1968, nr. 3, f. 163-164. Për këtë shih dhe R. Sokoli, *vep. cit.*, f. 129.

20) Ka dhe raste kur thyhet në katër vargjet e fundit.

fjala për rastin kur vallja thyhet). Në fund të kërcimit të dy valltarët përqafohen. Kjo është shenjë nderimi e respekti për njëri-tjetrin, që dijtën kaq bukur të kërcëjnë. Vallja zgjat disa minuta gjersa të mbarojnë vargjet e këngës.

Vallja dyshe e thatë përveç se nga një grup (është fjala për gjithë grupin e këngëtarëve) luhet edhe nga dy grupe të ndara. Kjo formë nuk e prish fare rregullin e valles. Të gjitha karakteristikat që përmendëm më sipër, lidhur me mënyrën e interpretimit, janë të vlefshme për të dy grupet. Në këtë rast, ndërmjet këtyre dy grupeve, krijohet një dualitet se kush prej tyre do të këndojë e vallzojë më mirë.²¹ Këngës ja thotë njëri grup: citon vargun e parë duke e shoqëruar edhe me kërcim, ndërsa grupi tjetër e shoqëron duke kënduar e kërcyer lehtë. Po këtë varg, duke e shoqëruar me kërcim, e përsërit dhe grupi tjetër. Në këtë mënyrë vallja sa vjen e merr vrull, bëhet më tërheqëse deri sa thyhet. Në këtë rast, me kërcim, mund të mirren një, dy ose më shumë melodi këngësh.

Vallja përçarke e kënduar, njëkohësisht e shoqëruar me cingonë e lodër, ka nga pikëpamja koreografike gjithashtu ndërtim dypjesësh. Ndërhyrja herë pas herë e këtyre veglave duket sikur e prish këtë rregull. Kjo mund të duket e tillë vetëm nga ana e jashtme.

Zakonisht valltarët e nisin vargun e parë të këngës në vend (i pari ja merr, i dyti ja mban, kurse të tjerët mbajnë iso). Gjatë ligjërimit ose kur përsërisin vargun për së dyti e nisin kërcimin (motivin koreografik të valles së kënduar) (Foto 5). Pastaj përsëritet e njëjta frazë muzi-



Foto 5

21) Një fenomen i tillë është i njohur. Në Labëri e hasim tek vallja labe. Këtë e ndeshim edhe në vallet «dyshe» të veriut: herë duke kërcyer dy valltarë në një anë, dy në anën tjetër ose kërcëjnë një herë dy të parët, fill pas tyre kërcëjnë dy të tjerë; ose e kërcen i pari vallen, pastaj ndrojnë vend për ta marrë vallen i dyti.

kore nga instrumentistët me ndryshime të vogla, si në drejtim të melodisë, dinamikës, ashtu edhe ritmit më të precizuar; ndërkaq valltarët e nisin kërcimin (motivin koreografik të shoqëruar me cingonë e lodër). Kur përsëritet vargu i dytë, valltarët nuk qëndrojnë në vend si në rastin e parë, por duke kënduar, kërcëjnë; kërcëjnë përsëri edhe kur të njëjtën frazë e përsërisin cingona me lodrën. Kështu vallja përsëritet deri sa në një moment të caktuar, thyhet. Thyrja përsëritet pothuajse e njëjtë si në rastin kur shoqërohet me këngë, ashtu edhe kur e njëjta frazë ripërsëritet me cingonë e lodër. Në këtë rast, kur thyhet, luhet vetëm nga dy të parët, kurse të tjerët i shoqërojnë pas duke kërcyer lehtë. Motivet koreografike që përbëjnë tërësinë e valles «përqarke» nga ajo e «thatë», pësojnë një farë ndryshimi. Ky ndryshim qëndron jo vetëm në karakterin dinamik të ekzekutimit, por dhe në përcaktimin më me ritëm të lëvizjeve.

Duke pasur parasysh, *Vallen e thatë* dhe *Përqarken* lidhur me këto forma kërcimi²², shikojmë evolucionin që ka pësuar vallja e kënduar si në brendinë plastike-ritmike, ashtu dhe në trajtë. Ngjet po ai fenomen si për vallet e grave. Duke u larguar qoftë edhe për një çast nga shoqërimi polifonik dhe duke u gërshtuar me instrumenta popullore, vallja e kënduar e burrave tashmë i nënshtrohet një formacioni tjetër, në gjysëm rrethi (në valle marrin pjesë deri 10-15 burra sipas vendit), një ekzekutim dhe interpretim disi tjetërsoj të motiveve të valles.

Siç shihet, vallja e kënduar, me variantet e saj, zë një vend me rëndësi në repertorin e vallëzimit të rrjedhës së sipërme të luginës së lumit Shkumbin. Kjo, jo vetëm për vlerat e saj, për gjërësinë territoriale në të cilën praktikohet, por edhe se ky lloj vallëzimi përbën një nga argëtimet më të afërta me të cilin banorët e kësaj zone shprehin ndjenjat, mendimet e tyre për veten dhe për jetën.

Me gjithë vlerat që ka kënga polifonike dhe vallja e kënduar e kësaj zone, prapëseprapë ato dallohen nga kënga dhe vallja e kënduar që luhet në krejt trevën që shtrihet midis Shkumbinit dhe Vjosës. Vetë këngëtarët, valltarët popullore, duke pasë parasysh këtë lloj kënge e valleje thonë: «Shpati, Dumreja, Mokra, sidomos Gramshi, i kanë më me sevda, se vallen e kanë kërcyer më me lajka». Vetë materiali koreografik, karakteri në përgjithësi i ndërtimit të këtij tipi kërcimi, mënyra e interpretimit të le të kuptosh se valleja e kënduar e burrave të kësaj zone shpreh në një farë mase karakteristika të tjera ose, më mirë të themi, vjen duke u zbehur, përderisa vazhdon gjer në një farë kufiri dhe nuk praktikohet më. Kjo kushtëzohet edhe nga fakti se, në këtë zonë, shfaqen forma të ndryshme, siç janë *Vallja e thatë* dhe *Përqarkja*, bile edhe gërshtime apo përshtatje motivesh, qoftë dhe pjesë të tjera, si p.sh. thyerjet, të afërta këto edhe me ndonjë prej kërcimeve «dyshe».

Në repertorin e vallëzimit të burrave të kësaj zone një vend të rëndësishëm zënë edhe vallet e shoqëruara me cingonë e lodër. Ato paraqiten në dy lloje: kërcime «dyshe» dhe valle «grup». Parashtrimin dhe analizën e materialit, për këto dy lloje të vallëzimit popullore, do ta bëjmë në mënyrë të veçantë.

22) Në Bërzeshtë na ra rasti të shohim vallen «Ç'u mbush mali plot me dushk», e cila u luajt me këngë, si dhe me cingonë e lodër. Në të dy rastet ajo u luajt e njëjtë, pra me motivet e *Valles së thatë*. Kjo tregon se ekzistojnë forma të tilla të ndryshme.

Kërcimet dyshe — Repertori i kërcimeve «dyshe» që shoqërohen me cingonë e lodër është i gjerë. Si Rrajca (me fshatrat: Sutaj, Skënderbej, ose katundi Plak, Prenjas — fshati, Pishkashi, Skroska etj.), nga kjo anë dhe Bërzheshta, Farreti, Karkaveci, Fanja, Sopot, Qukës-Skënderbej, Xhyra, Dardha, Spathari, Babja, Polisi etj., në krah të majtë të lumit, i konsiderojnë këto valle si të tyret. Është vështirë t'i japësh prioritet këtij apo atij fshati, meqenëse ata janë jo larg dhe kanë jetuar në marrëdhënje të afërta me njëri-tjetrin.

Këtu poshtë po japim përmbledhtas repertorin që e ndeshim në disa nga pikat e mësipërme. Në këtë mënyrë do të krijohet një mendim sadopak i plotë mbi specifikën e kësaj zone²³.

Në krahun e Rrajcës luhen këto kërcime: *Vallja e vdekjes*²⁴, *Thikat*, *Fletët e hudhrës*, *Rosat*, *Dollapçja*, *Polisarja*, *Jarninaja*, *Bërdilka* etj. Luhen edhe kërcime të tjera që kanë (të paktën për këtë zonë) karakteristika të disa prej valleve të mësipërme si p.sh. *Elbasançja*, *Beratçja* e *Gorës*, *Çupat* etj. ose edhe me karakteristika të veçanta (sidomos për pjesët e para të valles) si Isuf Arapi etj.; luhet edhe *Çermenikja* etj.

Në krahun e Bërzeshës luhen: *Vallja e vdekjes* (ose *Vallja me thuma*), *Thikat*, *Polisarja*, *Bërdilka* (ose *Bërdinka*) *Jarninaja*, *Elbasançja*, *Beratçja*, *Havaja e re*, *Çermenikja* etj.. Por luhen edhe valle të tjera që në zonën e Rrajcës nuk praktikohen si: *Qermania*, *Fusharja*, *Babja*, *Beliçarja*, *Pilipiska*, *Gurabardhja* (më rrallë), *Koçaxhikja*, *Ostreniçja* etj.

Le të zbresim tani poshtë rrjedhjes së Shkumbinit për të parë repertorin e valleve që luhet vetëm në dy fshatra: Polisin nga e majta dhe Kokrevën nga e djathta e tij.

Në Kokrevë luhen këto valle: *Thikat*, *Çupat*, *Qermania*, *Fusharja*, *Babja*, *Elbasançja*, *Beratçja*, *Beliçarja*, *Filifiska*, *Daskallja*, *Vallja e Kokrevës*²⁵, e *Hotolishtit*, *Çermenikja*, *Gurabardhja*, *Dyshja* (Foto 7), *Malenakja* etj..

Në Polisi luhen këto valle: *Polisarja* ose *Havaja e parë*, *Qermania*, *Fusharia*, *Elbasançja*, *Beratçja*, *Çermenikja*, *Çupat*, *Gurabardhja*, *Ostrençja*, *Çërrakja* etj.; *Vallja e vdekjes* nuk luhet dhe aq.²⁶

Pasqyra e sipërme tregon afërsisht se çfarë është e përbashkët ose jo në repertorin e kërcimeve «dyshe» të kësaj zone. *Vallja e vdekjes*, *Thikat*, *Pilisaria*, *Bërdilka*, *Elbasançja*, *Beratçja*, *Jarnina* e ndonjë tjetër luhen si në krahun e Rrajcës dhe n'atë të Bërzeshës, kurse *Fletët e*

23) Nuk mendojmë se kemi arritur në një regjistrim të plotë të repertorit të kërcimeve «dyshe» që luhen në këtë zonë.

24) Vendasit thonë se kjo valle luhet, zakonisht, në fund.

25) Në fshatin Kokrevë *Vallja e vdekjes* pak njihet. Tek *Vallja e Kokrevës* vëmë re motivin e dridhjes së këmbës n'ajër përpara, që është karakteristikë e *Valles së vdekjes*. Valltarët vendas e shpjegojnë këtë karakteristikë të *Valles së Kokrevës*.

26) Përtej Polisit në Shpat (rr. Elbasanit) tipike është vallja e kënduar. Përkundrazi, në të djathtë të Shkumbinit, ç'kap prej Rrajce gjer në Dragostunjë, në lok. e qendrës Librazhd dhe më thellë në krahinën e Çermenikës, ky lloj kërcimi luhet fort. Ja, në përgjithësi, repertori i kërcimeve që luhen në këtë zonë: *Qermania*, *Fusharja*, *Havaja e vjetër*, *Dyshja*, *Elbasançja*, *Beratçja*, *Gurabardhja*, *Polisarja*, *Martina*, *Toskallja*, *Martaneshja*, *Velija*, *Dervençja*, *Ostrençja*, *Koçaxhikja*, *Cupat*, *Përqarkja*, *Gabelçja* etj.; *Vallen e vdekjes* pak e njohin. Këto kërcime tregojnë informatorët Xh. Dosku (dt. 1928 Dorzë) dhe Xh. Roshi (dt. 1922, Zdrajzh) luhen në gjithë Çermenikën ç'kap prej Orenje, Dorëze e kalon gjer në kufi të Rrajcës: Banorë nga Stebleva e Gollobordës (rr. Dibres) thonë se në këtë fshat *Vallja e vdekjes* luhet edhe sot e kësaj dite.

hudhrës, Rosat, Dollapçja, Isuf Arapi e ndonjë tjetër janë karakteristike për krahun e Rrajcës. Vallet e tjera, që luhen në Bërzeshtë dhe në fshatrat e asaj ane si *Qemania, Fusharja, Babja, Havaja e re, Beličarja, Pilipiska, Gurabardhja, Koçaxhikja, Ostrençja* etj., janë karakteristike të kësaj ane. Ato përkojnë edhe me repertorin e valleve që luhen në anën e përtejme të lumit, në *Çermenikë*, në lok. e Qendrës Librazhd, në Kokrevë (pjesërisht) e gjetiu. Bën përjashtim *Eibasançja* dhe *Beratçja*, që luhen pothuaj në të gjitha pikat e mësipërme. Si përfundim mund të themi se, duke zbritur nga Rrajca e Bërzeshta në të dy anët e lumit, kryesisht në të djathtë të tij, repertori i valleve fillon të ndryshojë, deri sa në lok. e Qendrës e më tej në *Çermenikë* ndërron pothuaj krejtësisht, të paktën për vallet që janë karakteristike vetëm për Rrajcën.

Megjithatë, jo gjithmonë emërtimi të çon në burimin e vërtetë të ngjashmërisë ose të ndryshimit të fenomenit artistik-valle, sepse është i njohur mendimi që vallet në vetvete s'kanë kufi të prerë, ato kanë gjëra të përbashkëta, sikurse kanë edhe karakteristika të veçanta.

Natyrisht, shpërndarja e këtyre valleve në një zonë relativisht të madhe, siç është rrethi i Librazhdit, shpjegohet me arsye të ndryshme: marrëdhënje ekonomike (tregu), lidhje martesore, tranzumancat etj.. Kanë ndikuar në një shkallë të madhe edhe instrumentistët popullorë (ustallarët), të cilët duke bërë jetë ambulante, sa në njërin krahinë në tjetrën, janë bërë në mënyrë të pakuptueshme përhapës të këtyre kërcimeve; më fort do të thonim të melodive të valleve se sa të vetë valleve, megjithqë ata janë edhe njohës të tyre.

Emërtimi, përveç se na jep njohuri rreth përhapjes gjeografike të fenomenit artistik-valle, në një farë shkalle na afron edhe me përmbajtjen, origjinën e tij²⁷. Në repertorin e vallëzimit të kësaj zone dallojmë valle me përmbajtje rituale si *Vallja e vdekjes*; valle me kuptim simbolik: *Thikët* (që e ka humbur kuptimin fillestar), *Fletët e hudhrës, Rosat, Dollapçja, Qemania*; valle me kuptim vendi: *Fusharja* (valle fusharake); valle me kuptim krahinor: *Çermenikja, Devollicja*; me kuptim emra qytetesh: *Beratçja, Elbasançja*; valle me kuptim emra fshatrash: *Polisarja, Gurabardhja, Babja*; valle me kuptim njerzish: *Isuf Arapi*; valle me kuptim emra kështjelle: *Koçaxhikja* etj. Luhen edhe valle me kuptim të ndryshme si *Beličarja, Pilipiska, Jarnina* etj.²⁸ Disa nga këto valle të lënë të kuptosh se në bazë të tyre kanë meloditë e kënduara.²⁹ Sidoqoftë, problemi i origjinës së këtyre kërcimeve (lidhur me to dhe i melodive përkatëse) bëhet i vështirë për t'u shpjeguar, kur dihet se ato kanë kohë që luhen dhe rreth tyre nuk është shkruar fare.

Në gojën e vendasve kërcimet e këtij lloji i emërtojnë në mënyra të ndryshme: përdorin termin «kërcim» në vend të termit «valle». E quajnë «kërcim» kur luhet nga dy valltarë, kurse «valle» kur luhet me shumë valltarë. U thonë edhe «dyshe» se luhen nga dy valltarë ose

27) Për ndonjë kërcim që është i fondit tradicional shpesh përdorin edhe dy emërtime: përveç emërtimit (emërit) përkatës edhe një emër tjetër, p.sh. *Havaja e parë* dhe *Havaja e vjetër* etj. Kjo herë-herë e pengon dallimin midis tyre.

28) Tek vallet «grup» hasim emërtime të tilla: me kuptim simbolik: *Shqipëria*; me kuptim fisi, emër mali: *vallja e Mushaqit*; me kuptim emra fshatrash *Velçanka*; me kuptim fjalësh të huaja: *Asqerishte* ose *Sqerishte*; me kuptim zhvendosje në hapësirë: *Përçarkja* etj.

29) Ja disa nga këto këngë: *Ti moj flet e hudhrës-o / Dil m'i thirr së bukrës. Të më vishet me të holla / Të lulëzojë si lulëzon molla.* (E tregoi Mine Malo, dt. 1881, Rrajcë). *Rosë moj rosë / Kush ta shkuli bishtin. Ma shkuli rosaku / Ju theftë bardhaku.* (E tregoi H. Turtulli, dt. 1928 Rrajcë).

përdorin termin zakonisht të njohur «vënçe», d.m.th., valle të vendit, të krahinës apo të fshatit. Rëndom përdorin përpara emrit të kërcimit, edhe fjalën «hava»³⁰.

Kërcimet «dyshe» të burrave karakterizohen nga elemente të përbashkëta si në anën strukturale, ashtu dhe në trajtë; po ndërmjet tyre kanë edhe gjëra që i dallojnë.

Pa përjashtim luhen nga dy valltarë, të cilët kapen për dore ose për krahu (më rrallë). Gjatë kërcimit valltarët (sidomos i pari), i lëvizin shamitë lart n'ajër, jo simbas një rregulli të caktuar, më fort simbas dëshirës, simbas momentit që kërkohet. Shpesh ndodh që, në kërcim e sipër, valltarët shkëputen për të kërcyer secili më vete (p.sh. tek *Thikat, Polisarja, Vallja e vdekjes* etj.); ose shkëputen për të kërcyer vetëm i pari, ndërsa i dyti e mban apo e shoqëron lehtë me kërcim (p.sh. tek *Fletët e hudhrës, Rosat, Dollapçe, Qermania, Fusharja, Havaja e re*³¹, etj. Kjo është karakteristike për disa kërcime dhe më tepër duket n'ato raste (sidomos tek kthesat) kur vallja kërkon nga interpretuesit aftësi të veçanta: zotërim të kërcimit, shkathtësi, gjallëri, manovrim nga një lëvizje në tjetrën, ulje të mëdha, hedhje me të dyja këmbët, hedhje me rrotullin 360° etj. Në këto çaste edhe trupi, duke u shkëputur nga toka, luan rol në paraqitjen e figurës plastike, në fiksimin e saj. Është kjo arësyeja që valltari i parë, për të kërcyer me virtuozytet, ka nevojë për shokun pranë tij që ta mbajë. Edhe i dyti, ndonëse s'kërcen si i pari, ka një rol jo të vogël; ai duhet të jetë i vëmendshëm, të ndjekë me sy ritmikuisht lëvizjet, që luan i pari, për të ditur kohën se kur dhe si ta mbajë shokun e tij, i cili gjithë mendjen dhe forcën ja jep valles. Edhe meloditë, në këto raste, karakterizohen nga një dinamikë e ritëm i gjallë, shpeshherë i shpejtë nga fundi.

Kërcimet «dyshe», të shoqëruara me cingonë e lodër, paraqiten të pasura përse i takon motiveve koreografike. Këta, herë qëndrojnë më vete, kur shprehin një mendim të caktuar, herë kombinohen me njëritjetrin ose me lëvizje të ndryshme që nuk përsëriten në mënyrë të vazhdueshme gjatë kërcimit, por që së bashku shprehin një ide koreografike më të gjerë (në përgjithësi motivet paraqiten të ngjeshura e lakonike). Lëvizjet përbërëse të këtyre motiveve shprehin figura nga më të ndryshmet, të cilat shumë herë arrijnë, nëpërmjet plastikës, në përgjithësi simbolike. Mënyra e lidhjes, e raportit të këtyre lëvizjeve ndërmjet tyre, nga ana tjetër karakteri dinamik e sidomos gjerësia plastike shprehen në forma të shumëllojta. Përmbajtja, që pasqyrohet në tërësinë e çdo kërcimi nëpërmjet këtyre lëvizjeve, është tepër e gjallë, e fortë, me tipare burrërore. Nuk është shpejtësia shpeshherë që i karakterizon në thellësi ato, se sa ajo forcë e brendshme me kontraste, që shpërthen hovshëm, herë ngadalë e me ritëm që vjen duke u shpejtuar, herë shpejt e me lëvizje të shkathta; përsëri vjen një çast; e ndalin vrullin për të marrë forca të reja, për të kërcyer më fort, më me gjallëri, duke ja dhënë të gjitha energjitë e tyre kërcimit, lëvizjeve të këmbëve, trupit e duarve. Shpejt e në mënyrë të prerë, por me kuptim, shprehet mendimi në këto kërcime, sidomos tek kthesat. Burimin e kësaj veçorie duhet ta kërkojmë në përmbajtjen dhe strukturën e këtij kërcimi, në të cilin lëvizja e ritmi muzikor janë në unitet të pandarë, ashtu sikurse edhe dinamika, pavarësisht se nuk ekziston përputhje, në shumë raste në

30) Hava, trq.: arie. mënyra e të vallëzuarit.

31) Ky kërcim nuk duhet ngatërruar me *Havan e re*, e cila luhet «grup», djem e vajza bashkë ose edhe veças.

mes të frazave muzikore e figurave koreografike. Lidhja e këtyre komponentëve, shumëllojshmëria e figurave plastike e ritmike, që krijohen gjatë shtjellimit të valles, na jep atë që është tipike për karakterin, stilin e këtij lloji vallëzimi. Këto veçori janë karakteristika të strukturës së vetë këtyre kërcimeve. Por kërcimet «dyshe» karakterizohen edhe nga një spontaneitet i dukshëm, si në drejtim të interpretimit ashtu dhe ndaj motiveve, trajtimit a gërshetimit të tyre, shtesave apo heqjeve të ndonjë lëvizjeje. Kjo, nuk e prish, përkundrazi e pasuron fizionominë dhe gamën e mjeteve shprehëse të këtyre kërcimeve. Çdo ekzekutim dhe interpretim i këtij kërcimi është dhe një lloj improvizimi brënda kufirit të caktuar (trungut) dhe asnjëherë një shembull i plotë dhe i përfunduar krijimi me një formë të palëvizur. E përgjithshmja, që qëndron në vazhdimësi dhe përbën fijet lidhëse, është stili, i cili konsiston në tërësinë e shfaqjes së elementeve përbërëse të kërcimit. Nuk është për të mos përmendur, në këtë rast, rolin ndikues të veglave që i shoqërojnë këto kërcime, cingonën e lodrën më fort si instrumenta dinamikë, shprehës, stimulues në ekzekutimin dhe intepretimin e tyre. (Foto 6-7).



Foto 6

Të gjitha këto tipare evidencohen gjatë ekzekutimit të valles, nëpërmjet rritjes në mënyrë graduale të ritmit të muzikës që i shoqëron. Në këtë drejtim egziston një unitet i plotë. Kështu fillimi i çdo kërcimi nis ngadalë (me përjashtim të ndonjë rasti), me lëvizje disi të gjera e ritëm të shtruar. Përkundrazi, mbas këtij çasti, kur kërcimi thyhet, atëhere




Foto 7

ritmi vjen duke u shpejtuar, njëkohësisht lëvizjet bëhen më të gjalla, më të shpejta, më shprehëse. Në qoftë se në pjesët e para të valleve lëvizjet zhvendosen në drejtim të vargut të valles nga e djathta ose anasjelltas, përpara dhe prapa etj., në disa nga këto kërcime thyerjet karakterizohen nga kryqëzime diagonale me rrotullum (duke zënë secili valltar vendin e shokut), hedhja nga njëra këmbë tek tjetra, ulje të mëdha me të dyja këmbët duke u kapur sa me njëri me tjetri dorë, herë duke u larguar, herë duke u afruar përsëri në hedhje, ulje etj. (*Vallja e vdekjes, Thikat, Polisarja* etj.); ose duke kaluar në rreth me gjithfarë hedhjesh, uljesh, hedhje me njëri këmbë, ndërsa tjetra del e thyer përpara, përsëri ulje, rrotullime herë të ngadalta, herë të shpejta (*Dollapçja, Fletët e Hudhrës, Rosat, Isuf Arapi* etj.).

Kërcimet «dyshe» të kësaj zone përbëjnë një praktikë të gjatë, që është trashëguar që në kohët më të hershme e gjer sot. Kjo shpjegohet jo vetëm me traditën vendase³², me përmbajtjen, tiparet e karakteristikat shprehëse të këtij lloji vallëzimi, por edhe me përhapjen e tij (d.m.th. e llojit «dyshe» pavarësisht nga ndryshimet që kanë ndërmjet tyre) në një trevë relativisht të gjerë që përfshin: Çermenikën (rr. Librazhdit), Labinotin Mal, Zaranikën (rr. Elbasanit), Malësinë e Tiranës, Krujën,

32) Instrumentisti Halil Turtulli mjeshtër i pizgës, thotë se fisi i tij, brez pas brezi, i ka përdorur pizgat dhe lodrat. Ai e çon (me sa mban mend) deri në pesë breza, deri tek stërgjyshi i babës, fisin e tij. Rezulton afërsisht rreth 250-300 vjet që burrat e fisit i shoqërojnë këto valle me pizgë e lodër. Kanë banuar në katundin Plak (d.m.th. Skënderbej), nga ku thuhet se kanë zbritur më parë në Sutaj e më vonë në Rrajcë.

Matin, Martaneshin, Dibrën etj.. Mënyra e jetesës në kuadrin krahinor, sidomos terreni malor shpeshherë i ashpër, klima, lloji i muzikës dhe i instrumentave që i shoqërojnë, kontakti kanë lënë gjurmë të thella në këtë lloj kërcimi, qoftë këtej, qoftë përtej kufijve të sotëm shtetërore me të cilin kufizohet³³) rrethi Librazhdit.

Vallet grup — Një nga llojet e kërcimeve që shoqërohen me cingonë e lodër janë edhe vallet «grup». Luhen në krahun e Bërzeshtës por më fort në atë të Rrajcës. Nga të dhënat që kemi, lidhur me përhapjen e këtij vallëzimi, nuk rezulton që të luhet tutje kësaj zone, d.m.th. në rrjedhën e mëposhtme të Shkumbinit, sidomos nga Polisi në të majtë, dhe nga krahina e Çermenikës në të djathtë.³⁴

Në qoftë se u hedhim një vështrim këtyre valleve, do të vemë re se ato janë shumë të afërta ndërmjet tyre. Kjo na lejon të themi se kemi të bëjmë me një tip valleje me strukturë dhe përmbajtje të caktuar. Mbi bazën e tij ngrihen variante, më mirë do të thonim, zhvillime të disa motiveve përbërëse që kanë të bëjnë më tepër me kthesat e këtyre valleve. Këto karakteristika, që vihen re në motërzimet e këtij lloji, nuk kanë të bëjnë vetëm me motivet koreografike, por edhe me trajtën, formacionin, spontaneitetin, dinamikën etj..

Vallet «grup» luhen në formë gjysmë rrethi. Në valle marrin pjesë katër valltarë e lart (8, 10, 12 etj.) të kapur për dore, zinxhir. Lëvizjet lëhen në drejtim të vargut të valles anash nga e djathta. Shpesh, gjatë kërcimit, shkëputen për t'u rrotulluar nga e djathta.

Pa përjashtim të gjitha vallet «grup» fillojnë me paraqitjen (ekspozimin) e motivit kryesor (i cili ka edhe variantin e tij). Kërcimi nis shtruar, por nuk zgjat shumë dhe ritmi vjen e bëhet më i gjallë, më i shpejtë, më dinamik. Kështu edhe lëvizjet fitojnë plasticitet, gjallëri, sidomos tek variacioni i figurës së parë e poshtë, si rezultat i dublimit të tyre me hedhje të vogla, duke krijuar kështu larmi. Kjo e ka dinamizuar së tepërmi vallen. Edhe trupi, duart, çlirohen nga qëndrimi i zakonshëm, përveç këmbëve, të cilat në këtë çast evidencohen së tepërmi, edhe trupi, sidomos pjesa e sipërme, e shoqëruar nga krahët, vihet në lëvizje (një farë lëvizje e lirë) duke krijuar kështu nuanca të shumta. Fill pas këtij momenti vjen thyerja e valles. Këtu kërcimi shpreh përmbajtje tjetër, lëvizjet bëhen më të gjera, më të thyeshme, kërkohen frymëmarrje, herë duke u shkëputur me hedhje nga toka, herë duke u ulur ose duke u rrotulluar. Trupi gjithashtu kthehet herë djathtas herë majtas. Të gjitha këto lëvizje lidhen organikisht në përputhje

33) Nga të dhënat që patëm rastin të shtiem në dorë, kohët e fundit nga I. Hoxha, lidhur me repertorin e valleve të grave e burrave, që luhen në rrethin e Strugës, vëmë re egzistencën e një repertori të përbashkët vallesh në mes kësaj ane dhe rrethit të Librazhdit. Po përmendim disa prej tyre:

Tosharçja e vjetër, Beratçja, Anina, Koçaxhikja, Ostrençja, Çupat e Përmetit, Babo, Vallja e vdekjes (shoqëruar me pizgë e dauille); *Vallja çamçe, Vallja e dhëndërrit, Devollitçja, Vallja e plakave, Vallja e vajzave* (shoqëruar me saze), *Beliçarja, Çermenikja* (shoqëruar me çifteli e daire); *Plot dardha me lule të bardha* (valle të kënduara) etj. (krahaso me vallet që luhen në rrethin e Librazhdit e gjetiu). Në të ardhmen një problem i tillë do të bëhet objekt i një vëzhgimi më të gjerë.

34) Nga të dhënat që kemi mbledhur rastis të ndeshim ndonjë nga këto valle edhe në këtë anë. Nuk mund të përjashtohet njohja e tyre, por megjithatë s'janë një shfaqje e mirëfilltë. Me sa jemi në dijeni, ky lloj vallëzimi (duke përjashtuar disa elemente strukturale të motiveve) nuk luhet në krahinat e tjera, qoftë në trevën veriore ose atë jugore.

me rritjen ritmike e dinamike të melodisë së valles, ku një funksion tepër shprehës dhe stimulues kanë cingona e lodra.

Vallet «grup», në strukturë, kryesisht përsa i takon gërshetimit dhe përsëritjes së motiveve koreografike, paraqiten të inkuadruar në krahasim me kërcimet «dyshe» apo me vallet e kënduara polifonike të burrave (këtë karakteristikë e kanë edhe meloditë që i shoqërojnë këto valle). Ky inkuadrim rrjedh nga vetë natyra e valles, ritmi muzikor (gjithmonë në kohë të thjeshtë 2/4) dhe karakteri masiv.

Tendencat e evoluimit

Ndryshimet rrënjësore, që hapën rrugën e përparimit në fshatin e kolektivizuar, nuk ka se si të mos gjenin pasqyrim edhe në vallen popullore folklorike. Gjatë këtij çerek shekulli, në punën dhe jetën e tyre të përbashkët, vallja është bërë më e dashur për masat kooperativiste; ajo ka marrë një funksion e rol të veçantë. Tendencat, që vihen re në këtë drejtim, janë një tregues i qart i rritjes cilësore, i zhvillimit të valles së kësaj zone.

Këto elemente të reja po duken, ku më shumë e ku më pak, në të gjitha llojet e valleve të kësaj zone: tek vallet e grave, në ato të kënduarat, kërcimet «dyshe», të shoqëruara me cingonë e lodër, dhe vallet «grup».

Vallet e grave, ndonëse nuk kanë pësuar gjatë këtyre dy dekadave ndryshime të dukshme në motivet koreografike, prapëseprapë ato janë gjallëruar, kanë fituar një karakter dinamik më të theksuar përsa i takon interpretimit. Kjo vihet re në të gjitha vallet e mirëfillta të grave, sidomos tek vallja *Rroftë Enver Hoxha, Havaja e re, Vallja karakteristike e Bërzeshtës*³⁵ (e cila në bazë ka motivet e valles *Trëndafil i errët*, që luhet njëkohësisht me muzikë vokale dhe instrumentale).

Një nga faktorët kryesorë që çoi në këtë ndryshim, është vendosja e marrëdhëneve të reja shoqërore. Kjo, me kohë, çoi në shkëputjen e valles nga kuadri i ngushtë familiar dhe krahinor. Ajo nuk mund të shoqërohej, si dikur, vetëm me këngët intime të dasmës. Kërkonte diçka të re, forcën, dinamizmin e jetës dhe këtë element të ri ajo e gjeti tek njerëzit e rinj të punës. Kjo frymë e re e valles erdhi si rezultat dhe i masivizimit të saj, sepse vallja tashmë nuk luhej, si në të kaluarën, vetëm brenda katër mureve të shtëpisë, por doli jashtë n'oborr, në fushë, bile deri në skenë. Përdorimi, në këto kushte, gjithnjë e më shumë edhe i cingonës me lodrën për shoqërimin e valleve, bënë që ato të gjallërohen e të përtërihen së tepërmi.

Vallet e kënduara, ndonëse nuk e kanë atë përdorim të dikurshëm, prapëseprapë janë një element i dashur, sidomos për burrat e pleqtë. Ato janë larguar disi nga ai kuadër lirik e spontaneitet që i ka karakterizuar. Vallet e kënduara të kësaj zone janë bërë më të gjalla, sidomos kjo vihet re tek kthesat e tyre. Këtu ka ndikuar ngjashmëria e motiveve koreografike të disa prej këyre valleve me disa kërcime «dyshe», si dhe gërshetimi i dyfishtë në to i këngës me cingonën e lodrën. Në këtë rast është për t'u përmendur edhe karakteri masiv i valles, siç është p.sh.

35) Në Festivalin folkloristik kombëtar të Gjirokastrës, që u bë më 1968, kjo valle u luajt vetëm me cingonë e lodër nga grupi i vajzave të Bërzeshtës:

Përqarkja, që ka sjellë ndryshime në këtë formë të valles së kënduar në krahësim me *Vallen e thatë*. Në t'ardhmen kjo formë vallëzimi do të ndodhet përpara ndryshimeve të dukshme.

Kërcimet «dyshe» gjithmonë kanë qenë tërheqëse, të gjalla e të forta. Kjo është karakteristikë e natyrës së këtyre kërcimeve. Një faktor, që ka ndihmuar në përmbajtjen burrërore e shumë ekspresive të tyre, është cingona e lodra. Por, edhe këto kërcime, kanë përftuar elemente të reja, që konsistojnë në gjallërimin më të madh të tyre. Ky dinamizëm ka sjellë një far ngjeshje të strukturës së valles, me kërcime të shpejta nga pjesa e parë në kthesën e valles, zbehjen e disa nuancave të rastit, duke i dhënë në përgjithësi, atyre një karakter shumë lakonik, por shprehës, shpesh herë impulsiv. Këto kërcime luhen gjithmonë nga dy valltarë, megjithqë, në ndonjë rast, vihet re edhe tendenca për t'i kërcyer ato me katër valltarë (si p.sh. grupi i valleve të fshatit Kokrevë etj.), duke ruajtur formën «dyshe» (Foto 8) veçanërisht tek kthesat. Këto kërcime luhen sot në masën më të gjerë nga të rinjtë, burrat. Gjithashtu po përtërihen forma të ndryshme kërcimi, siç qe vallja e «Brezave» duke bashkuar në të dy, tri ose më shumë valle së bashku në interpretimin e të vegjëlve, të rriturve dhe burrave³⁶. Një formë e tillë nuk ka të bëjë me krijimin se sa me një mendim simbolik, që shpreh idenë e transmetimit të valles nga njeri brez tek tjetri.

Më fort nga të gjitha kërcimet, që praktikohen në luginën e sipërme të rrjedhës së Shkumbinit (sidomos në Rrajcë, Prenjas-fshat, Bërzeshtë etj.) dhe që kanë perspektivë në t'ardhmen, janë vallet të cilat luhen në «grup». Shkakun e këtij fenomeni e shikojmë në këto drejtime: a) në strukturën e përcaktuar të këtij tipi vallëzimi me motive koreografike që ripërsëriten në mënyrë të rregullt, b) në karakterin e thjeshtë të lë-



Foto 8

36) U shfaq në Festivalin folkloristik të Gjirokastrës, viti 1968.

vizjeve që mund të përvetësohen lehtë; c) në mundësitë që ka për t'u masivizuar, pra, pjesëmarrjen në të të një numri sa më të madh valltarësh etj.

Në gjirin e këtij lloj vallëzimi po shfaqet një tendencë tjetër: krijimi i valles së «përzier», ekzekutuar nga të rejat e të rinjtë. Në kuptimin ideoestetik kalimi në vallen e përzier është një hop cilësor i dukshëm që shpreh, nëpërmjet fenomenit artistik, valle, përmbysjen e botëkuptimit të vjetër, e pabarazisë së burrit me gruan, që na u trashëgua nga e kaluara. Në kushtet e marrëdhënjeve të reja socialiste të krijuara, kjo valle jo vetëm i bashkon, i gëzon të rinjtë, por në të njëjtën kohë i afron ata, sidomos të rejat, për të qenë më të lira në jetë ashtu sikurse në punë krah shokëve të tyre. Ne kemi të drejtë të themi se në këtë kapërcim, që është një domosdoshmëri objektive, vallja po ndryshon jo vetëm veten, por në të njëjtën kohë, me mjetet shprehëse të saj, po ndihmon për afrimin e gruas sa më afër jetës së përbashkët, emancipimit të saj, sidomos të të rejave që u përket e ardhmja (Foto 9).

Përmbajtja e re e kësaj valleje, që rrjedh nga prania e të dy seksëve (Foto 9), ka sjellë me vete një rritje të dukshme cilësore të elementeve



Foto 9

përbërëse të saj: trajtës (formacionit, lëvizjeve, mënyrës së interpretimit, duke i dhënë një karakter përgjithësisht plastik, tërheqës dhe një ritëm të gjallë, dinamik. Me gjallërimin e këtij lloj vallëzimi, sikurse edhe për kërcimet e tjera, një rol jo pa rëndësi po luan edhe cingona me lodrën.

Ndonëse motivet koreografike në këtë valle janë relativisht të pakta, ata karakterizohen nga një forcë e madhe shprehëse, burrërore, në të cilën spikat optimizmi masiv i ditëve tona. Pjesëmarrja e të rejave më vete ose së bashku me djemtë, ka çuar në rritjen cilësore, në pasurimin ideoestetik të këtyre valleve, duke u bërë kështu shprehje e realitetit tonë socialist, e punës dhe e jetës së përbashkët në fshatin e kolektivizuar.

Gjithë sa u tha më lart, janë një pjesë e vogël e gjithë asaj pasurie vallesh që fshihet e rron e gjallë në popullin puntor e artdashës të këtij rrethi. Për mbledhësit, studjuesit, përpunuesit e valles popullore folklorike, për të gjithë ata që e duan atë, kjo zonë, si dhe i gjithë rrethi i Librazhdit, është sa i pasur, i larmishëm, aq dhe burim i madh frymëzimi. Prandaj lypset që të gërmojmë, të mbledhim nga kjo tokë e paskelur për të njohur dhe mësuar atë që ka krijuar populli brez pas brezi. Këtë detyrë do ta kryejnë sot dhe nesër të gjithë ata... «që do të rrojnë gju më gju me popullin, që do ta duan atë me gjithë forcat e

shpirtit të tyre, që do të punojnë e do të lodhen me të, do të këndojnë dhe do të trishtohen tok me të». ³⁷

R é s u m é

TRAITS DES DANSES DE LA CONTREE DE RRAJCE ET BERZESHTE (DISTRICT DE LIBRAZHD)

Le district de Librazhd offre comme chorégraphie, par rapport aux autres parties de l'Albanie, une des régions les plus riches et les plus intéressantes pour ce qui est des danses populaires folkloriques. Cela, non seulement pour ce qui est des genres et des types de danses, mais aussi du fait que le territoire en question est à cheval entre deux grandes divisions, qui ont existé dans le passé. Cette ligne de démarcation régionale était tracée par le cours du Shkumbin, qui sépare en deux l'Albanie, celle septentrionale et celle méridionale.

Dans l'étendue de ce district, les genres et les types de danses passent des deux côtés du cours du fleuve, au point que souvent des éléments et des formes de danses sont imbriquées en synthèse, en donnant des formes particulières tantôt sur l'une tantôt sur l'autre berge. C'est la raison pourquoi ce district est devenu un objet d'études, et l'auteur de ce travail a choisi à cette intention une de ses contrées, celle de la vallée du cours supérieur du Shkumbin, qui a d'un côté Rrajce et de l'autre Bërzeshte avec les villages environnants.

En partant de tout le matériel des faits, du contenu, des genres et des types de danses, l'auteur les décrit dans des sous-chapitres particuliers, en tenant toujours présent le critérium genre, en même temps que l'aspect idéo-émotif, la forme, etc.

Au commencement il est question du lien de la danse, surtout dans le passé, avec les différentes formes du rituel. Il fait observer aussi l'existence des éléments ritualistiques dans la danse, les mouvements, la forme, et, en quelque cas, aussi dans le contenu, comme p.ex. dans la *Danse de la Mort*, etc. Tout de même, l'auteur se limite à des constatations et à quelque analyse, sans en faire l'objet d'un traitement à fond de cet aspect périmé, et qui commence à tomber en désuétude.

Avant d'entrer dans la présentation des danses, Agolli parle aussi des danses et de l'accompagnement musical. Il y parle du mode de chanter, homophonique, diaphonique, hétérophonique et polyphonique des chants, en général, qui servent à l'accompagnement des danses. De même il trace aussi la ligne de démarcation jusqu'où vont ces formes de chanter des deux côtés du cours du Shkumbin, ces éléments ayant un lien indissoluble avec les différentes formes de danses.

Au même titre que pour le genre du chant, des données sont brossées aussi pour les instruments en usage: la *cingone* ou la *pigze* (sorte de cornemuse ou de biniou) et la *lodër* (sorte de tambour), ainsi que les bornes jusqu'où ils sont en usage, l'intensité que ces instruments ont pris par rapport à l'accompagnement vocal, etc.

Les autres sous-chapitres sont destinés au traitement, en particulier, des danses féminines, des danses chantées masculines, les pas de deux et les danses en troupe.

Pour tous les genres et les types de danses, qui sont comprises dans cette division, l'auteur brosse un ample tableau du matériel chorégraphique, du contenu,

37) E. Hoxha, *Të zbatojmë me këmbëngulje e në mënyrë krijuese detyrat për revolucionarizimin e Partisë e të jetës së vendit*, Tiranë, 1968, f. 42.

de la forme et des valeurs idéologiques et esthétiques. Outre le vaste répertoire qu'il apporte, le traitement et l'analyse, l'auteur fait des estimations particulières aussi pour chacun de ces genres de danse, sur les éléments proches et différents qui existent entre eux, surtout en structure la priorité qu'à celle-ci ou cette autre forme de danse, leurs rattaches avec les formes de l'accompagnement vocal et instrumental, le caractère individuel ou massif de ces genres de danses, etc. Une importance toute particulière est donnée aussi au traitement des nouveaux éléments qui sont en train d'être introduits dans les danses (surtout après la libération du pays), comme le caractère massif, le passage à la danse mixte, le dynamisme, le débordement de la danse du cadre domestique étroit dans la vie sociale, etc. Une importance toute particulière est donnée aux affirmations réunies de la bouche des danseurs eux-mêmes. Ainsi ressort plus à l'évidence et plus confirmée l'opinion sur la danse.

Mais ce qui revient au plus important est le fait que l'auteur ne considère pas la danse dans le seul cadre géographique, de ses liens avec les formes de l'accompagnement musical, de son usage comme élément de passe-temps, mais en tout premier lieu comme un phénomène historico-social intimement rattaché à la vie et aux rapports sociaux, dans le cadre desquels elle a joué et joue un rôle important.

